



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 5103
Data: 23. 06. 2023

**PROCESVERBAL I DEBATIT PUBLIK
NË LIDHJE ME KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE
(KAB) 2023-2025 - PALDENICË**

Procesverbali nga Debatimi i tretë publik në lidhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026 u zhvillua me datën **15.06.2023** duke filluar nga ora 15:00 në Sallën e Takimeve, në SHFMU “Kështjella e Diturisë”, të cilin ishin gjithsej 12 pjesëmarrës, prej të cilëve 4 ishin gra dhe 8 burra.

Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025 e prezantoi Drejtorja për Buxhet dhe Financa, **znj. Lindita Ballazhi**, e cila fillimisht falënderoi të pranishmit dhe vlerësoi se kontributi i qytetarëve është shumë i rëndësishëm në hartimin dhe pasurimin e këtij dokumenti financiar komunal.

Lindita Ballazhi: Jemi në fazat e para për planifikimin e buxhetit për vitin 2024 dhe parashikimet për 2025 dhe 2026. Korniza afatmesme buxhetore është dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, që do të pasqyrojë caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike, për të përmbushur objektivat e përcaktuara me Strategjinë zhvillimore afatmesme komunale. Si pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme buxhetore (KAB), është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2024/2026, të dhëna nga Ministria e Financave (MF), përmes Qarkores buxhetore 2024/01 për komunitet, si dhe financimi nga grantet qeveritare dhe kufijtë fillestarë të buxhetit komunal për vitin 2024 dhe parashikimet për periudhën 2025 - 2026, që janë miratuar nga Komisioni i Granteve, si pjesë integrale e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) 2024 – 2026. Fazat për zhvillimin e KAB-it komunal dhe afatet kohore janë: në maj Pranimi i Qarkores Buxhetore 01/2024 Draftimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026, në qershor Konsultimet me Asamblenë Komunale, Mbajtja e Debateve Buxhetore dhe Aprovimi i KAB-it në Kuvend Komunal, në gusht Pranimi i Qarkores Buxhetore 02/2024 dhe Mbajtja e Debateve Buxhetore dhe në shtator Miratimi i Buxhetit Vjetor. Struktura e financimit komunal përfshinë: Granti i Përgjithshëm, Granti Specifik për Arsim, Granti Specifik për Shëndetësi dhe Projektionet e Të Hyrave Vetanake nga Komunitet. Në vitin buxhetor 2024, do të kemi këtë strukturë buxhetore të sigurimit të mjeteve dhe atë si vijon: nga Granti i Përgjithshëm me pjesëmarrje prej 1,583,941.00 € apo 47.29%, nga Granti Specifik i Arsimit me pjesëmarrje 1,089,623.00 apo 32.53%, nga Granti Specifik i Shëndetësisë me pjesëmarrje 401,338.00 apo 11.9% nga të Hyrat Vetanake Komunale me pjesëmarrje prej 274,376.00 € apo 8.19%, totali (Grantet + THVK) me pjesëmarrje prej 3,349,278.00 € apo 100.00 %. Në tabelat e paraqitura në KAB gjeni edhe Planin afatmesëm të të hyrave të buxhetit komunal për vitet 2024-2026, Planin e ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2024, si dhe Listën e Projekteve Kapitale

Lindita Ballazhi: Për projekt propozime për vitin buxhetor 2024 e hap diskutimin.

Propozimet:

Ahmet Krasniqi: Propozimet e mia janë:

- një hapësirë rekreative në fshat, ku të ketë parking, lojëra, ulëse dhe elemente tjera, i cili mundet me u shfrytëzuar nga të gjithë;
- rruga te Qupt pas çdo reshje aty bëhet problem i madh me u kalu rruga, sidomos nxënësit dhe duhet me u bo një zgjidhje;
- futja e përroit të I akrit në koritë, si cili është një nga përrojet më të mëdha me rreth 8 metra gjërësi dhe prej tij mundet me u shkaktuar probleme te shtëpiat afër;
- sigurimi i ujit të pijes;
- rruga që vjen deri te shkolla është planifiku keq, sepse ma shumë se gjysa e rrugës është trotuar dhe pjesa tjetër është rrugë për vetura dhe aty është shumë problem nëse veç takohen dy vetura, e do të ishte mirë që me u largu trotuari, sepse edhe ashtu nuk është që kalojnë këmbësor shumë.

Xhevahir Dernjani: Te përroi i Vakafit i cili shkon deri te Sharra, duhet me u vendos kanalizime për ato 7-8 shtëpi aty afër, por duhet të bëhet një lloj pastrimi i kanalizimeve tjera.

Përgjigjet:

Lindita Ballazhi: Në listën e projekteve për vitin 2024 janë të parapara disa projekte që përfshijnë edhe Paldenicën dhe zonën përreth, siç janë hapësirat rekreative apo parku, gjithashtu edhe kanalizimet janë të parapara për vitin 2024, kurse kërkesat tjera do t'i shqyrtojmë.

Lindita Ballazhi: A ka edhe dikush tjetër me shtu diçka? Nëse nuk ka, e konsideroj të mbyllur debatin publik.

Debati publik përfundoi në orën 15:30.



Lista e pjesëmarrësve- Debati publik mbi Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026

Data: 15.06.2023

Ora: 15:00

Vendi: SHFMU "Këshijella e Diturisë" - Paldenicë

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Pozita/Institucioni | E-mail | Telefoni | Nënshkrimi |
|-----|-------------------|---------------------|-----------------------------|-------------|------------|
| 1 | Ahmet Krasniqi | Drejtor shalle | ahmetkrasniqi@outlook.com | 044-146-518 | |
| 2 | Sadolla Axhami | | | 045-224-557 | |
| 3 | Hajrosh Krasniqi | | | 046-162-493 | |
| 4 | Mimir DEJANJANI | Puntor teknik | | 045-255-995 | |
| 5 | Tahir Qipi | Pushtan teknik | | 044,137-149 | |
| 6 | Krzehar Dermaj | Asamble | dermajkz@shfmu.com | 044,227,199 | |
| 7 | LIRIDONA BALAZHI | K.H-E | liridona.balazhi@shfmu.com | 044/862-571 | |
| 8 | Abderrahman Bushi | Drejtor i Bujti | Abderrahman.bushi@shfmu.com | 045/1928660 | |
| 9 | Natya Kalisi | DAP | natya.kalisi@shfmu.com | 045 813/639 | |
| 10 | ARSIM DEJANJANI | DSAPE | arsim.dejanjani@shfmu.com | 045/308-843 | |
| 11 | Minjete Muka | DSHMS | minjete.muka@shfmu.com | 045/691-560 | |
| 12 | Armin Jusuf | DKARS | armin.jusuf@shfmu.com | 044 909 704 | |
| 13 | LIRIDONA BALAZHI | ZYRA E KRYETARIT | | | |
| 14 | | | | | |

